



Agjencia e Akreditimit e Kosovës  
Kosovo Accreditation Agency  
Agencija za Akreditovanje Kosova

Qendra e Studentëve, kati i II-të  
10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel : +381 38 213-722  
Fax:: +381 38 213-990  
e-mail: [kaaoffice@gmail.com](mailto:kaaoffice@gmail.com)  
web: [www.akreditimi.org](http://www.akreditimi.org)

Nr. 183/09 dt. 24.07. 2009

Për: Institutin e shkencave aplikative dhe organizative "PJETER BUDI"

Mbështetur në LAL 2/2003 dhe Udhëzimet administrative që dalin nga ky ligj: UA 14/2003 për Licencimin e institucioneve private të arsimit të lartë në Kosovë, UA 11/2004 për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës, UA 1/2009 për Akreditimin e Institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë dhe UA 12/2009 mbi kriteret dhe procedurat për akreditimin e Shkollave të larta profesionale dhe Shkollave të larta teknike në Kosovë), dëshiroj t'ju njoftoj se Këshilli Kombëtar i Cilësisë i Agjencisë së Akreditimit të Kosovës ka shqyrtuar aplikacionin tuaj për akreditim dhe ka vendosur si në vijim:

#### **Programet e akredituara**

- Programi Dogana dhe Shpedicion (ne nivelin Bachelor- Ba)
- Programi Menaxhim i Turizmit dhe Hotelierise (ne nivelin Bachelor- Ba)

Do të akreditohen për një vit në rastin e parë (1 Tetor 2009-30 Shtator 2010) me kushtet vijuese që duhet plotësuar gjer më 1 Shtator 2009:

1. Të dëshmohet se institucioni posedon burime të mjaftueshme njerëzore (staf akademik vendor) dhe materiale (hapësirë, bibliotekë dhe pajisje për mësimdhënie) për implementimin e programeve të akredituara
2. Të përmirësohet dukshëm furnizimi i bibliotekës me tituj mësimor për lëndët bazike në fushat e ofruara të studimit dhe me revista shkencore në gjuhën angleze
3. Të dorëzohet në AAK Plani i përmirësimit të cilësisë në institucion (follow up) i përpiluar në bazë të rekomandimeve të Ekspertëve që duhet të përmbushen gjer në vizitën e ardhshme.

### **Programet që nuk do të akreditohen**

- Programi Sigurimet (ne nivelin Bachelor- Ba)
- Programi Menaxhment i Përgjithshëm – Administrim Publik (ne nivelin Bachelor- Ba)
- Programi Menaxhment i Përgjithshëm –Ekonomia e Ndërrmarrjeve (ne nivelin Bachelor- Ba)

nuk akreditohen dhe nuk duhet të regjistrojnë studentë të rinj.

### **Akreditimi institucional**

Akreditimi si Institut

Ju mund të pranoni studentë në programet e akredituara më lartë që fillojnë më 1 tetor 2009 por nuk mund të pranoni studentë në programet e pa akredituara. Duhet të siguroni se çdo student i pranuar në njërin nga programet e akredituara është regjistruar në njërin prej gradave akademike të ofruara më lartë. Nuk lejoheni që të shpallni konkurs në asnjërin nga programet e pa akredituara, pa marrë parasysh a është specifikuar më lartë apo jo.

Studentët të cilët momentalisht ndjekin studimet në një program të pa akredituar duhet të njoftohen për statusin e akreditimit të programit të tyre para se të regjistrohen në vitin akademik 2009-10

Ju duhet të siguroni se çdo kusht për akreditim i cili është specifikuar më lartë do të plotësohet gjer në datën e caktuar. Ne do të shqyrtojmë përgjigjen tuaj dhe do të vendosim nëse edhe ndonjë vizitë e ekspertëve do të jetë e nevojshme. Nëse po, atëherë të gjitha shpenzimet e bëra do të mbulohen nga ju.

MASHT-i së shpejti do të hartojë një Udhëzim administrativ me të cilin do të kërkon nga ju që të ofroni emrat dhe shënimet tjera personale për studentë të cilët kanë përfunduar programet e akredituara , së bashku me Shtojcën e diplomës për çdo student, që do të na lejoj ne lëshuarjen e certifikatës së Diplomës të mbështetur nga Agjencia e Akreditimit e

Kosovës për secilin student që ka diplomuar nga data 7 korrik 2009. Ftoheni që të sjellni te ne dizajnin e çdo çertifikate që dëshironi që ta lëshojmë.

Ju gjithashtu ftoheni që të paraqitni aplikacionin për programe tjera të studimit (pa marrë parasysh a janë paraqitur më herët apo jo). Ne do të jemi në gjendje që të pranojmë këto aplikacione nga 1 Tetori 2009 e tutje. Ju përkujtojmë se të gjitha aplikacionet duhet të plotësojnë kërkesat nga UA 2/2009 ose UA 12/2009.

Më lejoni që t'ju uroj për marrjen e akreditimit dhe shpresoj që të bashkëpunojmë edhe në të ardhmen sepse ne punojmë së bashku që të përkrahim përmirësimin e vazhdueshëm të arsimit të lartë në Kosovë.

Prishtinë, 24. 07.2009

Me respekt,  
Basri Muja, u.d. Drejtor

